



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues: Autoriteti i Mbrojtjes Audiovizive
Nr. 82E/1 Prot./ datë 13.05.2015
Marrës: Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, dt. 20.05.15
Nr. 141/3 Prot./ datë 20.05.2015
Përmbajtja:

Dergohet per mendim projekt ligji

Për t'u trajtuar nga: Komisionet e Edukimit dhe Medias
Shenimi i titullarit:

Datë 20.05.2015 (_____)
Afati: 'NORMAL (7 ditë) 'PRIORITET (3 ditë) 'URGJENT (brenda ditës)
Kaluar nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në Protokoll, dt. 21.05.15

Marrë në dorëzim: Datë ____ . ____ . 2015

I kalon për trajtim _____

SHËNIM: _____


Datë ____ . ____ . 2015 (_____)

Marrë në dorëzim: Datë ____ . ____ . 2015

I kalon për trajtim _____

SHËNIM: _____

Datë ____ . ____ . 2015 (_____)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë

Tel.-Fax. + 355 4 226287, www.ama.gov.al

Nr. 827/1 Prot.,

Tiranë, më 13.05.2015

Drejtuar: Zj. Albana SHTYLLA
Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit

*Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", nr. 4
Tiranë*

Lënda: Dërgohet mendim për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"

E nderuar znj. SHTYLLA!

Në vijim të shkresës tuaj nr. 1711/1 prot., datë 07.05.2015, me të cilën keni kërkuar mendim për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ju sqarojmë se:

AMA është njohur me përmbajtjen e projektligjit të propozuar, për shfuqizimin e nenit 62 të ligjit nr. 97/2013 "Per mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" që parashikon rregullat dhe kufizimet e pronësisë në transmetimet audio dhe audiovizive tokësore dhe shprehet parimisht dakord për miratimin e tij, përveç pikës 12 të këtij neni që parashikon se asnjë zotërues i licencave kombëtare të transmetimeve audio dhe licencave kombëtare të transmetimit audioviziv, përfshirë OSHMA-të, të licencuar për shërbimin e programit audioviziv dhe/ose të autorizuar për shërbimin e programeve të mbështetura në rrjete satelitore, nuk mund të transmetojë më shumë se 30 për qind të reklamave në tregun e transmetimeve audioviziv. Propozojmë që pika 12 e nenit 62, të mbetet në fuqi.

AMA vlerëson se kuadri ligjor mbi të cilin mbështetet veprimtaria e autoritetit rregullator duhet të aktivizojë potencialin teknik, ekonomik të medias, si një faktor kyç i shoqërisë së informacionit, duhet të liberalizojë më shumë tregun, të promovojë konkurrencën, krijimin e klimës së duhur të investimeve, por njëkohësisht të promovojë rolin e radios dhe televizionit në aspektin social, kulturor dhe edukues.

Zhvillimet e vrullshme teknologjike në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shoqërisë së informacionit janë shoqëruar me një gamë të gjerë shërbimesh audio dhe audiovizive që ofrohen në rrjetet e komunikimeve elektronike. Ligji në fuqi parashikon kufizime të pronësisë vetëm për licencat e transmetimit audio dhe audiovizive tokësore dhe satelitore, ndërkohë që nuk parashikon asnjë kufizim pronësie për ofrimin e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive që mbështeten në rrjete kabllore, internet, platformë IPTV, OTT etj. Kujtojmë se bazuar në legjislacionin në fuqi, autorizimet për ofrimin e shërbimeve të programeve të mbështetura në këto rrjete të komunikimeve elektronike, jepen vetëm me kërkesë, pa iu nënshtruar asnjë procesi konkurrimi, brenda një afati 30 ditor nga marrja e kërkesës së plotësuar. Nga ana tjetër, zhvillimet teknologjike kanë ndryshuar konceptin e radios dhe televizionit tradicional pasi janë rritur burimet e marrjes së informacionit, siç u përmend më lart. Koncepti i kufizimeve të pronësisë në mediat audiovizive ka patur si qëllim marrjen e masave për nxitjen e pluralizmit në media si dhe promovimin e diversitetit të përmbajtjes në media.

Në kushtet aktuale, me regjime lehtësuese të marrjes së autorizimeve për ofrimin e shërbimeve audiovizive, sigurohet praktikisht jo vetëm pluralizëm në tregun mediatik, por ajo çka është më e rëndësishme, pluralizëm i përmbajtjes së programeve audio dhe/ose audiovizive. Pra, zbatimi i rregullave për kufizimet e pronësisë nuk përbën tashmë një element promovues të parimeve të sipërcituara.

Shërbimet programore që ofrohen prej subjekteve që pajisen me licencë transmetimi audio dhe/ose audiovizive tokësore pra, që përdorin frekuenca radiotelevizive që janë burim natyror i fundmë janë të kufizuara në numër. Po ashtu, licencimi i këtyre subjekteve i nënshtrohet një procesi konkurrimi publik, për të garantuar shfrytëzimin sa më efektiv të spektrit të frekuencave. Kështu, numri maksimal i programeve që mbështeten në 5 rrjete numerike private kombëtare është 75 programe, ndërsa numri i programeve që mund të mbështetet në një platformë të vetme IPTV është mbi 100 programe.

Po ashtu, ligji nr. 97/2013, në dispozita të tjera parashikon rregullime ligjore specifike dhe të qarta për të evituar situatat e monopolit në tregun audio dhe audioviziv. Më konkretisht, neni 63 i këtij ligji parashikon se një subjekt i pajisur me licencë për transmetime numerike ose për ofrimin e shërbimit të programit audio ose audioviziv nuk mund të ketë më shumë se një të tretën e sasisë së përgjithshme të programeve përkatësisht lokale, rajonale dhe kombëtare, në varësi të llojit të licencës së disponon.

Ndërsa garantimi i konkurrencës së ndershme si një prej funksioneve kryesore të autoritetit rregullator, AMA-s, realizohet më së miri, në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, i cili, është organi i ngarkuar ligjërisht për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KRYETAR,

GENTIAN SALA

